



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

Nr. 128 Prot.

Tiranë, më 06/03/2021

**U D H Ë Z I M**

**Nr. 1, datë 06/09/2021**

**PËR**

**SHPALLJEN E AFATEVE TË KANDIDIMIT, SI DHE DORËZIMIN E  
DOKUMENTACIONIT PËR ANËTARË TË KOMISIONEVE TË PËRHERSHËM PËR  
DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR" DHE DISA AUTORITETE  
DREJTUESE NË UPT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës", neni 6, pika 2/2.1, neni 18 dhe 25, si dhe urdhrin nr. 36, datë 28.07.2021 të Rektorit "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve udhëzon:

1. Dokumentacioni i kandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore "Doktor" dhe disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, do të dorëzohet pranë Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, sipas nenit 25, pika 1 të rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës".
2. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete (KZF), të shpallin afatin për fillimin e dorëzimit të dokumentacionit të vetëkandidimit në KIZ.
3. Afati për dorëzimin e dokumentacionit të fillojë në datën 10.09.2021 dhe të përfundojë në datën 14.09.2021, ora 16:00.
4. Komisionet e Zgjedhjeve në Fakultete, të shpallin kriteret dhe listën e dokumentacionit për kandidim në përputhje me nenin 25, pika 1 të rregullores.

5. KZF – të do të tërheqin listën e dokumentave të dorëzuar pranë KIZ në datën 14.09.2021, ora 17:00 për të kryer regjistrimin përfundimtar të kandidatëve.
6. Brenda datës 16.09.2021, KZF të dërgojnë në KIZ një kopje të vendimit për regjistrimin e kandidatëve. Vendimi publikohet nga KZF dhe një kopje e tij i vihet në dispozicion kandidatëve.
7. Formularët që duhet të plotësohen nga kandidatët për aplikimin për anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” dhe disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, të jenë sipas modeleve bashkëlidhur këtij udhëzimi.
8. Vendet vakante për të cilat zhvillohet procesi zgjedhor janë :
  - A. Anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në çdo fakultet.
  - B. Drejtues të njësive bazë si më poshtë:

**Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit:**

- Departamenti Gjeodezisë;
- Departamenti Hidraulikës dhe Hidroteknikës

**Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike:**

- Departamenti i Automatikës

**Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit:**

- Departamenti i Inxhinierisë Informatike;
- Departamenti i Bazave të Informatikës

**Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike:**

- Qendra e Gjuhëve të Huaja

**Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës:**

- Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës

**Instituti i Gjeoshkencave:**

- Departamenti i Meteorologjisë;
- Departamenti i Sizmologjisë

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE**

**KRYETARI**

**GJERGJI ISLAMI**

